



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 893 prot

Tiranë më 05.5.2023

URDHËR

Nr. 67, datë 05.5 2023

PËR
“CAKTIMIN E KOORDINATORIT PËR MONITORIMIN E PLANIT TË
INTEGRITETIT”

Në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kodit të Etikës për Zyrën së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Urdhrit nr.160, datë 28.09.2022 “Për miratimin e Planit të Integritetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2022 - 2025”,

URDHËROJ

1. Caktimin e Koordinatorit për monitorimin e Planit të Integritetit për Zyrën e Komisionerit 2022-2025.
2. Koordinatori do të jetë përgjegjës për monitorimin e Planit të Integritetit dhe hartimin e një raporti vjetor për situatën e aktiviteteve dhe masave që duhet të merren gjatë realizimit të secilit aktivitet.
3. Në cilësinë e Koordinatorit, caktohet Zj. Pamela Begaj, Inspektore pranë Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Integrimit.
4. Koordinatori do të mbështetet sipas rastit edhe nga punonjësit e secilës drejtori.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

